2) Realizimi si me karakter publik ashtu edhe privat, për llogari të vet, me marrjen e tenderave, apo për llogari të tretëve me marrje të tenderave, të punimeve të ndërtimit në përgjithësi, përfshirë ndërtimin e ndërtesave të çdo lloji dhe për çdo destinacion dhe realizim të veprave të veçanta prej beton armeje, punimeve të restaurimit, ristrukturimit, shkatërrimit, punimet e lidhura dhe/ose aksesore me të mësipërmet.



B) PRODHIMI, TREGTIA, IMPORTIMI, EKSPORTIMI, SHPËRNDARJA DHE TREGTIMI i:

- Veshjeve të çdo lloji, përfshirë veshjet sportive;
- Aksesorëve të veshjeve me çdo lloj materiali, përfshirë këpucët, çantat dhe rripat;
- Produktet tekstile dhe lëndë të tjera për realizimin dhe konfeksionimin e veshjeve dhe aksesorëve të veshjeve, përfshirë lëkurët dhe peliçet;
- Qeseve, copave dhe çantave prej letre, plastike, stoffe dhe fibrash natyrale dhe sintetike në përgjithësi; artikuj të tjerë prej letre dhe kartoni në përgjithësi;
- Ora, artikuj bizhuterie dhe parfumerie, kozmetikë dhe artikuj reklame;
- Artikujve shtëpiake, artikujve për arredimin, artikujve për dhurata dhe produkteve tipike të zejtarisë;

C) PRODHIMI DHE PËRPUNIMI PËR LLOGARI TË VET DHE PËR LLOGARI TË TË TRETËVE I ARTIKUJVE PËR REKLAMË PREJ STOFI, si me fibra natyrale ashtu edhe me fibra sintetike;

D) MARRJA E PËRFAQËSIVE TREGTARE NË PËRGJITHËSI.

Gjithashtu shoqëria mund të bëjë sa është e nevojshme, sipas gjykimit ekskluziv të organit administrativ për zbatimin e objektit të shoqërisë dhe kështu ndër të tjera:

- Të bëjë operacione tregtare, industriale, financiare, bankare, hipotekare, mobiliare dhe imobiliare;
- T'i drejtohet çdo forme financimi me institute kredie, banka, shoqëri dhe privatë, duke u dhënë garancitë e nevojshme mobiliare dhe imobiliare, reale dhe personale;
- Të japë garanci bankare, garanci të tjera dhe garanci reale;
- Të marrë pjesë në konsorciume dhe grupime ndërmarrjesh.

Të gjitha aktivitetet duhet të zhvillohen në kufijtë e normativave që rregullojnë zhvillimin e aktivitetit, në veçanti në respektim të normativës në fushën e aktiviteteve profesionale të mbrojtura dhe me natyrë kreditimi dhe financiare

SISTEMI I ADMINISTRIMIT DHE KONTROLLIT

Sistemi i administrimit i përshtatshëm: ADMINISTRIM KOLEGJIAL ME SHUMË PERSONA

Subjekti që ushtron kontrollin kontabël: REVIZOR LIGJOR

KËSHILLI ADMINISTRATIV

Numri i anëtarëve në detyrë: 4

INFORMACIONE PËR STATUTIN


Tagra nga statuti:

Neni 17 – Shoqëria administrohet, në alternativë: a) Nga një administrator i vetëm; b) Nga dy ose më shumë administratorë deri në një maksimum prej pesë që përbëjnë këshillin administrativ;

Lloji i administrimit dhe numri i administratorëve përcaktohen nga ortakët njëkohësisht me emërimin e tyre. Të gjithë administratorët mund të jenë edhe jo ortakë dhe janë të rizgjedhshëm.

Ortakët, njëkohësisht me emërimin e disa administratorëve apo me vendim të mëpasshëm, mund t'u besojnë atyre tagrat e administrimit që duhet të ushtrohen veç e veç ose bashkarisht, pa ndryshuar kompetenca e këshillit administrativ për hartimin e projektit të bilancit dhe në hipoteza të tjera të parashikuara nga ligji në mënyrë të pashmangshme.

Këshilli mund të delegojë plotësisht ose pjesërisht atributet e tij, që nuk janë të delegueshme me ligj, njërit apo disa asministratorëve të deleguar.





Organi administrativ qendron në detyrë deri në revokim apo dorëheqje ose për kohëzgjatjen e përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit. Administratorët janë të revokueshëm në çdo kohë me vendim të ortakëve, me përjashtim të së drejtës për dëmshpërblim të dëmeve të mundshme nëse revokimi i administratorit të emëruar me afat të caktuar kohor bëhet pa një shkak të drejtë.

Pushimet e administratorëve për skadencë të afatit apo dorëheqje kanë efekt nga momenti në të cilin krijohet organi administrativ. Sidoqoftë administratorët e mbetur në detyrë, ata të pushuar dhe organi i mundshëm i kontrollit duhet t'ia nënshtrojnë vendimit të ortakëve çështjen e rikrijimit të organit administrativ në kohën më të shkurtër të mundshme dhe sidoqoftë brenda tridhjetë ditësh.

Kur shoqëria administrohet nga një këshill administrativ, nëse për çdo lloj shkak mungon gjysma e administratorëve, bie i gjithë këshilli.

Nëse këshilltarët e pushuar nga detyra janë më pak se gjysma mund të zëvendësohen nga administratorët e mbetur në detyrë me anë të koptimit, me mënyrat sipas neneve 2385 dhe 2386 të kodit civil.

Administratorët mund të marrin cilësinë e ortakëve përgjegjës pa kufizim në shoqëri konkurruese, të ushtrojnë një aktivitet konkurrues për llogari të vet apo të të tretëve dhe të jenë administratorë apo të kryejnë funksionet drejtuese në shoqëri konkurruese.

Neni 18 – Organi administrativ i ka tagrat nga më të gjerat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm dhe për këtë ka të drejtë të bëjë të gjitha aktet që i konsideron të nevojshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve të shoqërisë, përjashtuar vetëm ato që me ligj i rezervohen në mënyrë të pashmangshme vendimit të ortakëve; mund edhe të lejojë fshirjen e hipotekave pa përmbushjen e plotë të kredisë së garantuar dhe pa hequr dorë nga hipoteka ligjore edhe në rast mospagimi të çmimit të shitjes.

Neni 19 – Administratorët kanë përfaqësimin e përgjithshëm të shoqërisë përballë të tretëve dhe në gjykim, me mënyrat e mëposhtme.

Kur shoqëria administrohet nga një këshill administrativ, përfaqësimi i shoqërisë për ekzekutimin e vendimeve të këshillit i takon të gjithë administratorëve veç e veç ndërmjet tyre; nëse u janë besuar tagra administrimi administratorëve të veçantë veç e veç apo bashkarisht edhe përfaqësimi, në lidhje me ushtrimin e këtyre tagrave, nënkuptohet që u është dhënë atyre me të njëjtat mënyra.

Organi administrativ mund të emërojë drejtorë të përgjithshëm, administrativë dhe teknikë, si edhe përfaqësues për çështje apo kategori çështjesh të veçanta, duke përcaktuar detyrat dhe shpërblimet.

Neni 20 – Këshilli, në rast se nuk i kanë marrë masat ortakët në momentin e emërimit, zgjedh mes anëtarëve të tyre kryetarin dhe ndoshta një zëvendës kryetar, që ushtron funksionet të së parit në rast mungese apo pengese të tij.

Këshilli mbledhet në selinë e shoqërisë dhe gjatë, mjafton që të jetë në territorin italian, kur kryetari e konsideron të nevojshëm apo kur bëhet kërkesë në formë më shkrim nga të paktën një administrator, pas thirrjes së bërë nga kryetari nëpërmjet komunikimit me shkrim që përmban datën, vendin dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, fton të gjithë administratorët dhe anëtarët e organit të mundshëm të kontrollit, të paktën pesë ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen, ose në rast urgjence të veçantë të paktën njëzet e katër orë përpara; komunikimi mund të dërgohet edhe me telefaks apo me postë elektronike, në adresën e dhënë më përpara nga i interesuari dhe që është shënuar në librin e vendimeve të administratorëve; në rast pamundësie apo mosaktiviteti të kryetarit këshilli mund të thirret nga njëri prej administratorëve. Në mungesë të thirrjes formale këshilli vendos në mënyrë të vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë administratorët dhe anëtarët e organit të mundshëm të kontrollit. Vendimet e këshillit administrativ merren me votën pro të shumicës së administratorëve në detyrë; në rast barazie mbizotërojnë vota e kryetarit. Këshilli emëron një sekretar, edhe jashtë tij, që harton proces verbalin e vendimeve dhe e firmos bashkë me kryetarin. Vendimet e këshillit administrativ mund të merren edhe me anë të



konsultimit me shkrim, ose mbi bazën e konsensusit të shprehur me shkrim; këto forma të fundit me procedimin dhe mënyrat e parashikuara në nenin e mëposhtëm 22. Këshilli sidoqoftë duhet të mbledhet në formë kolegjiale për miratimin e projektit të bilancit dhe në hipotezat e tjera të parashikuara nga ligji

**KUFIZIMET E PËRGJEGJËSISË SË ORTAKËVE:
INFORMACION I PRANISHËM NË STATUT/AKT THEMELIMI.**

NDARJA E FITIMEVE DHE E HUMBJEVE NDËRMJET ORTAKËVE:

Neni 25 – Nga fitimet neto të ushtrimit duhet të zbritet një shumë e barabartë me të paktën një njëzetën pjesë të tyre, që është e destinuar si rezervë ligjore, deri sa kjo të ketë arritur një të pestën e kapitalit themeltar; pjesa që mbetet e fitimeve të ushtrimit u shpërndahet ortakëve, me përjashtim të ndonjë destinacioni të ndryshëm të vendosur nga ata.

**KLAUZOLAT E TERHEQJES:
Informacion i pranishëm në statut/akt themelimi.**

**KLAUZOLAT E PARABLERJES:
Informacion i pranishëm në statut/akt themelimi.**

INFORMACIONE FINANCIARE DHE PËR KAPITALIN

Kapitali i Shoqërisë në EURO:

i vendosur:	100.000,00
i nënshkruar:	100.000,00
i derdhur:	100.000,00

kontributi në para

**Kontribute dhe përfitime:
INFORMACION I PRANISHËM NË STATUT/AKT THEMELIMI .**

Instrumentat financiarë të parashkuar nga statuti:
-Titujt e debisë

Neni 26 – Shoqëria mund të emetojë tituj debie, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, pas vendimit të ortakëve të marrë me shumicën e parashikuar për ndryshimet statutore

VEPRIME TË JASHTËZAKONSHME

Projekti i shkrirjes me përthithje të shoqërisë

- PAIMEX ITALIA HDL S.R.L.

Selia: CERRETO GUIDI

Kodi Fiskal: 02140460482

Data e regjistrimit: 04/06/2024


- BY TWINS SRL

Selia: EMPOILI

Kodi Fiskal: 06671890488

Data e regjistrimit: 04/06/2024

Data e aktit: 30/05/2024



Projekti i ndarjes me themelim të shoqërisë së re

- PAIMEX IMMOBILIARE S.R.L.

Data e regjistrimit: 05/06/2024

Data e aktit: 30/05/2024

Shkrirje me përkthje e

- BY TWINS SRL

Selia: EMPOILI

Kodi Fiskal: 06671890488

Data e regjistrimit: 13/06/2024

- PAIMEX ITALIA HDL S.R.L.

Selia: CERRETO GUIDI

Kodi Fiskal: 02140460482

Data e regjistrimit: 13/06/2024

Data e vendimit: 05/06/2024

Ndarje me themelim të një shoqërie të re:

- BY TWINS IMMOBILIARE S.R.L.

Selia: CERRETO GUIDI

Data e regjistrimit: 13/06/2024

Data e vendimit: 05/06/2024

AKTIVITETI

Aktiviteti kryesor i ushtruar nga shoqëria:

Prodhim dhe përpunim për llogari të vet apo për llogari të të tretëve të copave, çantave dhe artikujve të tjerë të reklamës prej stoffe si prej fibrash natyrale ashtu edhe prej fibrash sintetike.

Data e fillimit të aktivitetit të ndërmarrjes: 04/10/2010

Aktivitet i ushtruar në selinë ligjore:

Prodhim dhe përpunim për llogari të vet apo për llogari të të tretëve të copave, çantave dhe artikujve të tjerë të reklamës prej stoffe si prej fibrash natyrale ashtu edhe prej fibrash sintetike që prej datës 04/10/2010.

TITULLARËT E DETYRAVE APO KUALIFIKIMET

*MEACCI LORIANA (përfaqësuese e biznesit)

lindur në CERRETO GUIDI (FI) më 13/10/1955

kodi fiskal: MCCLRN55R53C529D

-KRYETARE E KËSHILLIT ADMINISTRATIV e emëruar me akt datë 22/07/2010

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 09/08/2010

-KËSHILLËTARE e emëruar me akt datë 22/07/2010

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 29/01/2024

-ADMINISTRATORE E DELEGUAR e emëruar me akt datë 19/12/2023






Prezantimi: 15/01/2024

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 29/01/2024

Fuqitë:

- a) Të firmosë letërshkëmbimin tregtar dhe operativ;
- b) Të japë dispozita dhe të bëjë tërheqje parash nga llogaritë rrjedhëse bankare, edhe me anë të çeqeve bankarë me urdhër të të tretëve që duhet të vlejné për disponibilitetet në para dhe për dhënie e kredive përballë një arsyeje të dokumentuar në formë të duhur, deri në shumën maksimale prej euro 150.000,00 për çdo dispozitë të veçantë; të xhirojë çeqe dhe tituj të tjerë të emetuar apo të xhiruar me urdhër të shoqërisë për t'i derdhur në llogari bankare dhe postare në emër të vetë shoqërisë, të vendosë për shumat e depozituara në llogaritë bankare dhe/ose postare të shoqërisë me anë të urdhrave për transferta bankare, instrumentave të tjerë të pagesës, të kërkojë ekstrakt të llogarive dhe bllok çeqesh;
- c) Të lidhë, në emër dhe për llogari të shoqërisë, kontrata dhe polica sigurimi të çdo lloj natyre;
- d) Të lidhë, në emër dhe për llogari të shoqërisë, kontrata financimi, në format teknike dhe të negociimit që konsiderohen si më të përshtatshme, duke përcaktuar kushtet e shpenzimit dhe të rimbursimit;
- e) Të kërkojë, në emër dhe për llogari të shoqërisë lëshimin e garancive me kërkesë të parë dhe të garancive bankare (fidejusioneve) në interes të shoqërisë;
- f) Të arkëtojë çdo lloj shume që cilido i detyrohet shoqërisë, duke lëshuar mandat;
- g) Të administrojë të gjitha aktivitetet e rekuperimit të kredive, edhe me anë të operacioneve të çedimit të kredisë, të faktoringut, të shtyrjes së pagesave dhe/ose të heqjes dorë të pjeshme dhe/ose të plotë nga vetë kreditë, si edhe me anë të transaksioneve;
- h) Të lejojë ulje, fshirje dhe regjistrime hipotekore;
- i) Të heqë dorë nga sekuestrimet;
- j) Të blejë, të shesë dhe/ose të shkëmbejë automjete, duke bërë kur është e nevojshme praktikant pranë regjistrave publikë apo zyra të tjera kompetente. Të paarqesë përpara zyra të caktuara kallëzime për humbje të certifikatave të pronësisë, të librezave të qarkullimit, të targave dhe të pullave të sigurimit, si edhe të kërkesave për heqje të sekuestrimit dhe/ose kthim të automjeteve në pronësi të shoqërisë, me tagrën për të nëndeleguar të tretët për tërheqjen e tyre;
- k) Të bëjë çdo akt dhe përmbushje pranë të gjitha administratave publike dhe organizmave të së drejtës publike, përfshirë entet e sigurimeve shoqërore, fiskale dhe administrative në përgjithësi, për të marrë autorizimet, konçesionet dhe licensat dhe për të bërë të gjitha procedurat e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë;
- l) Të ngrejë padi dhe të paraqitet në çështjet ligjore që kanë të bëjnë me shoqërinë me të drejtën për të paraqitur dokumenta, për të bërë deklarata, për të ngritur padi si civile ashtu edhe penale, kërkesa gjyqësore dhe administrative në çdo shkallë të procedimit, duke emëruar, për këtë qëllim avokatë dhe përfaqësues me tagrën për t'u dhënë atyre të gjitha tagrat funksionale për realizimin e mandatit;
- m) Të pranojë, në emër dhe për llogari të shoqërisë, propozime për dëmshpërblim të shoqërive të sigurimit, të firmosë marrëveshje transaktive;
- n) Të bëjë çdo akt që duhet në funksionet e veta pranë Dhomës së Tregtisë, Industrisë, zejtarisë dhe Bujqësisë dhe pranë regjistrat të ndërmarrjeve të çdo province, duke firmosur aktet, modulet dhe çdo dokument tjetër, duke dhënë deklarime zëvendësuese të aktit publik dhe duke



bërë çdo gjë tjetër që nevojitet për hapjen, mbylljen dhe transferimin e zyrave, selive të mundshme dytësore dhe njesive lokale.

Për realizimin më të mirë të detyrës ajo mund të shfrytëzojë bashkëpunimin e konsulentëve të shoqërisë, si edhe punën e personave të caktuar dhe të personelit në vartësi në përgjithësi, edhe nëpërmjet lëshimit të qarkoreve dhe dispozitave të brendshme, në kuadër të një aktiviteti të koordinuar organizimi dhe zbatimi të masave të parashikuara nga normativa.

Përfaqësuesi i emëruar i ka të gjitha tagrat nga më të gjerat në lidhje me tagrat e deleguara më sipër në mënyrë të tillë që të mos i kundërshtohen mungesë apo pasaktësi tagrash.

Detyra i jepet me detyrimin për të dhënë llogari dhe nuk sjell asnjë detyrim vartësie pune dhe merr karakter të përkohshëm si një kontribut të pastër për aktivitetin profesional.

Përfaqësuesi, në lidhje me funksionet që i janë besuar dhe me përjashti të hipotezave në përgjegjësi të tij me dashje apo pa dashje, çlirohet nga shpenzimet ligjore, dënimet me gjobë, gjobat, sanksionet me gjobë, ose për dëmshpërblim të çdo lloj natyre të lidhur me procedime të mundshme gjyqësore që ata duhet të pësojnë në lidhje me funksionet e dhëna më sipër.

Kjo detyrë dhe prokura që vijon i jepen përfaqësuesit duke filluar nga data e sotme dhe pa afat të caktuar deri në revokim nga ana e shoqërisë apo heqje dorë të përfaqësuesit që duhet të komunikohet me shkrim me paralajmërim prej dy muajsh.

I deleguari, duke marrë në konsideratë përvojën profesionale, deklaron se është në zotërim të kërkesave të duhura dhe që mund të ushtrojë detyrat dhe funksionet e dhënë me tagrat nga më të gjerat organizuese, administruese dhe kontrolluese ashtu siç kërkohet nga natyra specifike e funksioneve të deleguara dhe deklaron se e pranon prokurën ashtu siç jepet në këtë akt.

*PAPINI ROSSANO (përfaqësues i biznesit)

lindur në CERRETO GUIDI (FI) më 13/04/1953

kodi fiskal: PPNRSN53D13C529T

ZËVENDËS KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV e emëruar me akt datë 22/07/2010

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 09/08/2010

-ADMINISTRATORE E DELEGUAR e emëruar me akt datë 19/12/2023

Prezantimi: 15/01/2024

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 29/01/2024

Fuqitë:

1) MBROJTJA E SHËNDETIT DHE E SIGURISË SË PUNËTORËVE.

Mbikqyr në funksionet e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë së punëtorëve, duke ngarkuar për përmbushjen dhe mbikqyrjen e të gjitha aktiviteteve, detyrimet dhe përmbushjet që i takojnë punëdhënësit me tagrat nga më të gjerat dhe në ushtrimin e funksioneve të veta, ose:

-të aplikojë dhe të bëjë që të aplikohen parashikimet ligjore, parashikimet e autoriteteve publike - dhe normativat e brendshme;

të aplikojë dhe të kontrollojë respektimin e të gjitha normativave në fuqi dhe emetimin e ardhshëm;

-të aplikojë praktikatat e mira të punës dhe të bëjë që të respektohen udhëzimet operative në fushën e sigurisë dhe të higjienës së punës dhe të gjitha dispozitat në lidhje me sigurinë e aktiviteteve të zhvilluara në vendet e punës së ndërmarrjes, në respektim të dokumentit të vlerësimit të riskeve dhe të Sistemit të Administrimit të Sigurisë në Punë të marrë duke mundur që të aplikojë sistemin me sanksione të parashikuara nga Kontrata kolektive e punës;





-të shfrytëzojë konsulentët dhe entete të ngarkuar nga ana institucionale për parandalimin e mosrespektimit të normativave të sektorit (ministritë kompetente, INAIL, ASL, drejtorisë provinciale të punës dhe entete të tjera të ngarkuara), si edhe të ekspertëve teknikë dhe të specializuara si edhe të shërbimeve të ndërmarrjes, duke autorizuar si rrjedhojë shpenzimet e nevojshme;

të verifikohet përshtatshmëria dhe të autorizohet me të shpejtë kërkesa për shpenzime dhe - investime në sektorin në fjalë, në përputhje me buxhetin dhe/ose planin e investimit të përpunuar specifikisht, duke marrë njëkohësisht të gjitha masat që do të bëhen të nevojshme. Përfaqësuesi autorizon dhe vendos blerjen e çdo malli dhe shërbimi, përfshirë këtu të gjithë materialet për parandalimin, mbrojtjen dhe çdo ndërhyrje tjetër që duhet të konsiderohet e nevojshme në ushtrimin e aktiviteteve të mësipërme dhe, sidoqoftë, merr masat pa asnjë limit shpenzimi për ndërhyrjet me urgjencë maksimale me përjashtim të llogaridhënies dhe marrjen dijeni të këshillit; -Të bëjë gjithçka tjetër që mund të konsiderohet e nevojshme ose e dobishme për ecurinë e mirë të shoqërisë në sektorin e kompetencës, edhe në respektim të normativave ligjore të aplikueshme në këtë fushë;

2) Në bazë të nenit 17 D. legjislativ 81/2008, punëdhënësi nuk mund të delegojë aktivitetet e mëposhtme:

- Si vlerësim të të gjitha rreziqeve me vlerësimin e "dokumentit të vlerësimit të rreziqeve";
- Caktimi i përgjegjësit të shërbimit të parandalimit dhe të mbrojtjes nga rreziqet.

3) Punëdhënësi mund të procedojë me atribuimin e prokurave dhe të nënprokurave, në bazë të nenit 16 dhe 18 të D. legjislativ 81/2008.

4) Përfaqësuesi, në bazë të nenit 16 D. Legjislativ 81/2008 (TU për sigurinë), duhet të marrë masat në veçanti për të përmbushur sa parashikohet nga ligji për mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në bazë të nenit 18 TU të sigurisë, ose:

a) Të caktojë paraprakisht punëtorët e ngarkuar për zbatimin e masave të parandalimit të zjarreve dhe luftën kundër zjarreve, për evakuimin e vendeve të punës në rast rreziku të rëndë dhe të menjëhershme, për shpëtimin, ndihmën e parë, dhe sidoqoftë për administrim të emergjencës;

b) Duke u ngarkuar detyrat punëtorëve, duke patur parasysh kapacitetet dhe kushtet e tyre, në raport me shëndetin e tyre dhe për sigurinë;

c) T'u japë punëtorëve mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme të mbrojtjes individuale, pasi dëgjohet përgjegjësi i shërbimit të parandalimit, të mbrojtjes dhe mjeku kompetent;

d) Të marrë masat e duhura me qëllim që vetëm punëtorët që kanë marrë udhëzimet e përshtatshme dhe një stërvitje praktike futen në zonat që ekspozohen në një rrezik të rëndë dhe specifik;

e) Të kërkojë respektimin nga ana e punëtorëve të veçantë të normativave në fuqi, si edhe të dispozitave të ndërmarrjes në fushën e sigurisë dhe të higjienës së punës dhe të përdorimit të mjeteve të mbrojtjes kolektive dhe të pajisjeve të mbrojtjes individuale të vëna në dispozicion të tyre;


f) Të dërgohen nëpërmjet strukturës së ndërmarrjes të ngarkuar për këtë, punëtorët për vizitën mjekësore brenda afateve të parashikuara nga programi i mbikqyrjes shëndetësore dhe t'i kërkojë mjekut kompetent respektimin e detyrimeve të parashikuara në ngarkim të tij nga TU për sigurinë;

g) Të marrë masat për kontrollin e situatave të rrezikut në rast emergjence dhe të udhëzime me qëllim që punëtorët, në rast rreziku të rëndë, të menjëhershme dhe të paevitueshme, të braktisë vendin e punës apo zonën e rrezikshme;





- h) Të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur punëtorët e ekspozuar ndaj riskut të një rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm për vet riskun dhe masat të marra ose që duhet të marrë në fushën e mbrojtjes;
- i) Të bëjë detyrimet e informimit, trajnimit dhe përgatitjes sipas neneve 36 dhe 37 të sigurisë;
- j) Me përjashtim të rasteve kur është e arsyetuar në mënyrë të duhur nga nevojat e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë, nuk duhet t'u kërkojë punëtorëve që të rimarin aktivitetin e tyre në një situatë pune në të cilën ekziston një rrezik i rëndë dhe i menjëhershëm;
- k) T'u lejojë punëtorëve që të verifikojnë, me anë të përfaqësuesit të punëtorëve për sigurinë, aplikimin e masave të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit;
- l) T'i dorëzojë me të shpejtë përfaqësuesit të punëtorëve për sigurinë, me kërkesë të këtij dhe realizimin e funksionit, një kopje të dokumentit të vlerësimit të rreziqeve, edhe në suport informatik, si edhe për t'i dhënë mundësi vetë përfaqësuesit që të ketë akses dhe të konsultojë të dhënat në lidhje me aksidentet në punë. Dokumenti konsultohet eskluzivisht në ndërmarrje;
- m) Të përpunojë dokumentin sipas nenit 26, pika 3, TU për sigurinë (DUVRI) dhe, me kërkesë të këtij dhe për realizimin e funksionit të tij, të dorëzojë me të shpejtë një kopje përfaqësuesve të punëtorëve për sigurinë; dokumenti konsultohet eskluzivisht në ndërmarrje;
- n) Të marrë masat e duhura për të shmangur që masat teknike të marra të mund të shkaktojnë rreze për shëndetin e popullsisë apo të shkatërrojnë mjedisin e jashtëm duke verifikuar periodikisht mungesën e zgjatur të rrezikut;
- o) Të konsultojë përfaqësuesin e punëtorëve për sigurinë në hipotezat sipas nenit 50 TU për sigurinë;
- p) Të marrë masat e nevojshme me qëllim të parandalimit të zjarreve dhe të evakuimit të vendeve të punës, si edhe për rastin e rrezikut të rëndë dhe të menjëhershëm, sipas dispozitave në bazë të nenit 43 Tu për sigurinë. Këto masa duhet t'i përshtaten natyrës së aktivitetit, përmasave të ndërmarrjes apo të njesisë prodhuese dhe numrit të personave të pranishme;
- q) Kur kërkohet nga ligji dhe me anë të strukturës së ndërmarrjes të përgatitur për këtë, të pajisjë punëtorët me testrën për identifikim, të pajisur me fotografi, me gjeneralitetet e punëtorit dhe paraqitjen e punëdhënësit;
- r) Të përditësojë masat parandaluese në lidhje me ndryshimet organizative dhe prodhuese që kanë rëndësi për qëllimet e shëndetit dhe sigurisë në punë apo në lidhje me shkallën e evolucionit të teknikës së parandalimit dhe të mbrojtjes;
- s) Të mbikqyrë me qëllim që punëtorët për të cilët është detyrimi i mbikqyrjes shëndetësore të mos ngarkohen me detyra pune specifike pa gjykimin e aftësisë për punë të parashikuara;
- t) T'i japë shërbimit të parandalimit dhe të mbrojtjes dhe mjekut kompetent, informacione në lidhje me:
1. Natyrën e rreziqeve;
 2. Organizimin e punës, programimin dhe zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse;
 3. Përshkrimin e impianteve dhe të proceseve prodhuese;
 4. Të dhënat dhe informacionet në lidhje me aksidentet në punë dhe ato në lidhje me sëmundjet profesionale;
 5. Vendimet e marra nga organet e mbikqyrjes;
- u) Të mbikqyrë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve në rastet sipas neneve 19 (detyrimet e të ngarkuarit), 20 (detyrimet e punëtorëve), 22 (detyrimet e projektuesve), 23 (detyrimet e prodhuesve dhe të furnizuesve), 24 (detyrimet e instaluesve) dhe 25 (detyrimet e mjekut kompetent) të TU për sigurinë, pa ndryshuar përgjegjësi ekskluzive e subjekteve të detyruara në





bazë të të njëjtëve nene në rast se mbrojtimi i detyrimeve të mësipërme i ngarkohet vetëm atyre dhe nuk konstatohet një difekt në mbikqyrjen e punëdhënësit dhe të drejtuesve;

v) Sa është parashikuar dhe udhëzuar nga nenet 18 (detyrimet e punëdhënësit), 26 (detyrimet e lidhura me kontratat e tenderave për punime apo dorëzime), 36 (informim të punëtorëve), 37 (trajnim të punëtorëve dhe të përfaqësuesve të tyre), 43, 64, 66 (punë në mjedise të dyshuara për ndotje), 71, 77, 82 (punë nën tension), 83 (punë në afërsi të palëve aktive), 85 (mbrojtje të ndërtesave, impianteve, strukturave dhe pajisjeve), 96 (detyrimet e punëdhënësve), 111 (detyrimet e punëdhënësit në përdorim të pajisjeve për punime në lartësi), 163, 164, 168 (detyrime të punëdhënësit), 169 (informim, trajnim dhe përgatitje), 193 (përdorim të mjeteve të mbrojtjes individuale), 225, 226, 227, 228, 235, 237 (masat teknike, organizative, procedurale), 248 (konstatim i pranishmërisë së amiantit), 272 (masat teknike, organizative, procedurale), 289 (parandalim dhe mbrojtje lundër shpërthimeve), 291 (detyrimet e përgjithshme), 292 (koordinimi). Përfaqësuesit, në referim - në mënyrë të veçantë por josh ekskluzivisht - me parashikimet e neneve 64, 71, 168 të TU për sigurinë, i atribuohet një autonomi e plotë vendimarrëse dhe administrimi të të gjitha tagrave dhe detyrave të deleguara pa patur mundësi shoqëria që të ushtrojë asnjë detyrim për shpenzimet dhe aktivitetin.

Përfaqësuesi do të marrë masat pa asnjë kufizim shpenzimi në ndërhyrje me urgjencë maksimale, me përjashtim të llogaridhënies:

Gjithmonë përse i përket funksioneve për mbrojtjen e sigurisë së punëtorëve, përfaqësuesi do të ketë tagra firme për aktet dhe për dokumentacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të deleguara si edhe për tagrën e firmosjes së letërshkëmbimit.

5) Mbrojtja e të dhënave personale.

Përfaqësuesi mund:

- Të bëjë gjithçka që është e nevojshme me qëllim për të respektuar dispozitat në fushën e privatësisë sipas D. legjislativ 196/2003 dhe me ndryshimet në vazhdim si edhe dispozitat sipas rregullores BE 2013/679 të parlamentit evropian dhe të këshillit datë 27.04.2016 "në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, si edhe për qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave" (C.D. RGDP). Në cilësinë e titullarit të trajtimit të të dhënave personale, shprehimisht duke e autorizuar që të shfrytëzojë subjektet e mundshme të jashtme që kryejnë funksionet e përgjegjësit të mbrojtjes së të dhënave personale;

- Të përfaqësojë shoqërinë Paimex s.r.l. duke u impenjuar me firmën e vet, në realizimin e aktiviteteve që futen në kompetencat e rolit të dhënë, duke siguruar në veçanti, në cilësinë e titullarit të trajtimit, koordinimin e aspekteve në lidhje me normativën në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KËSHILLËTAR i emëruar me akt datë 22/07/2010

Kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 29/01/2024

*PAPINI GIACOMO

lindur në EMPOLI (FI) më 31/07/1986

kodi fiskal: PPNGCM86L31D403I

-KËSHILLËTAR i emëruar me akt datë 22.07.2010

kohëzgjatja në detyrë PA AFAT

Data e Regjistrimit: 09.08.2010

*PAPINI DENISE



lindur në FUCECHIO (FI) më 04.01.1977
kodi fiskal: PPN DNS77A44D815X
-KËSHILLËTARE e emëruar me akt datë 30.06.2014
Prezantimi më 29.07.2014
kohëzgjatja në detyrë PA AFAT
Data e Regjistrimit: 08.09.2014

***PAPINI FILIPPO**

lindur në EMPOLI (FI) më 11.08.1957
kodi fiskal: CRSFPP57M11D403L
-REVIZOR LIGJOR i emëruar me akt datë 20.01.2025
Prezantimi më 17.02.2025
kohëzgjatja në detyrë DERI NË MIRATIMIN E BILANCIT që mbyllet në datë 31/12/2027
Data e Regjistrimit: 19/02/2025

REGJISTRI I REVIZORËVE LIGJORË

Nr. 86040 datë 28/09/1999

Lëshuar nga-enti MINISTRIA E EKONOMISË DHE E FINANCAVE

SELI DYTËSORE DHE NJESI LOKALE

- Njesi lokale MAGAZINË/VEND DEPOZITIMI
CERRETO GUIDI (FI) VIA DELLA REPUBBLICA, 148/150/CAP 50050
Fraksioni TABBIA

Aktiviteti i Ushtruar:

Magazinë/vend depozitimi

Data e Hapjes: 01.08.2020

Kjo certifikatë paraqet njoftimet/të dhënat e rregjistruara në Rregjistër deri në ditën e sotme.

Kjo certifikatë nuk mund të paraqitet në organet e administratës publike apo në administratorët privatë të shërbimeve publike.

PULLA E TAKSËS E PAGUAR NË MËNYRË VIRTUALE. AUTORIZIM I DEPARTAMENTIT TË FINANCAVE TË FIRENCES NR. 56607/92 DATË 22.07.1992.

PAGUAR PËR TAKSA PULLE 6 EURO 96,00

PAGUAR PËR TË DREJTA EURO 5,00

SHUMA: EURO 101,00

TOTALI PËR SHUMAT E SHPREHURA NË LIRETA: 195561

Gjithashtu deklarohet që në regjistrin e ndërmarrjeve, për pozicionin e shoqërisë në fjalë, nuk rezultoi e regjistruar asnjë procedurë falimentimi, në bazë të normativës në fuqi në këtë fushë.






Gjithashtu deklarohet që nuk rezultoi regjistruar në Regjistrin e Bizneseve, për pozicionin e shoqërisë në fjalë, që të jetë në proces asnjë procedurë falimentimi, në bazë të normativës në fuqi në këtë fushë.

FUNKSIONARI I NGARKUAR
PËR RUAJTËSIN
Dr. Brunella Tarli
VIRGINIA SILANO
(firma, vula)

****fund i certifikatës****



PREFEKTURA E FIRENZE

APOSTILA

(Konventa e Hagës datë 5 Tetor 1961)

1. Shteti: ITALI
Ky akt Publik
2. është firmosur nga Virginia Silano
3. në cilësinë e Funkionarit
4. është i paisur me vulën/pullën e Dhomës së Tregtisë Industrisë
Zejtarisë dhe Bujqësisë së Firences

VËRTETOHET

5. në Firenze
6. në datë 16.05.2025
7. nga Prefektura e Firenze
8. Nr. 0091485-2025
9. Vula/Pulla
10. Firma:

Operator Administrativ
Mario Nicoli
(firma dhe vula)

Kjo Apostile vërteton vetëm firmën, cilësinë e firmëtarit dhe vulën/pullën që është vendosur. Nuk vërteton përmbajtjen e dokumentit për të cilin është lëshuar.

Unë, Vjollca META, përkthyesë zyrtare e gjuhës italiane certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 412 datë 31.07.2024 deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha italiane në gjuhën shqipe me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

Më datë 03/06/2025

Perkthyesë zyrtare
Vjollca META



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



**DATE 12/06/2025
NR REP 5045**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 12/06/2025 përpara meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

PËRKTHYESE:

Vjollca Meta, atësia Sulejman, amësia Shpresa, shtetase Shqiptare, lindur në Shijak, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rajoni Nr.2, Rr. 'aleksander Goga'; Nd. 0000; H. 00; Ap. 000; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 18/04/1967, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037321010 dhe nr. personal G75418084G;

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Italiane në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"; në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
JULIAN ZHELEGU

